



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 korrik 2012
Nr.ref.: RK/283/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI117/11

Parashtrues

Ridvan Hoxha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit Komunal në Prizren nr.
01/011-4539 të 18 qershorit 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ridvan Hoxha, këshilltar në Kuvendin Komunal të Prizrenit (në tekstin e mëtejme: KK Prizren).

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet vendimi i KK-së Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, me të cilin lejohet „...dhënia e pronës së komunës për shfrytëzim- pa kompensim, toka bujqësore me sipërfaqe prej 5-6 hektarësh, e cila gjendet në rrugën lokale për në fshatin Nashec, e evidentuar si pronë shoqërore e KK Prizren, për ndërtimin e kompleksit shkollor nga ana e qendrës edukative-arsimore “Gulistan“.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vendimi i KK Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, me të cilin toka e komunës i është dhënë në shfrytëzim pa kompensim, e me të cilën sipas pohimeve të parashtruesit janë shkëlur nenet 3, 24, 46 dhe 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme:Ligji) dhe Rregullin 56 paragrafi 2 i Rregullores së Punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës më 18 gusht 2011 ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me Vendimin (nr. GJR.117/11 të 23 gushtit 2011) e Kryetarit, gjyqtarja Iliriana Islami është caktuar Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin nr. KSH.117/11 të Kryetarit, është caktuar Kolegji Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez dhe Ivan Čukalović.
7. Me Vendim të Kryetarit (nr. GJR. 117/11 të 2 korrikut 2012), gjyqtari Altay Suroy u emërua gjyqtar raportues në vend të gjyqtarës Iliriana Islami së cilës më 26 qershor 2012 i përfundoi mandati në pozitën gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.
8. Më 11 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. KK Prizren, pas shqyrtimit të kërkesës për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim, të parashtruar nga ana e qendrës edukative-arsimore „Gulistan“, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, në seancën e mbajtur më 18 qershor 2009, ka miratuar VENDIMIN nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009 për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim të përhershëm me të cilin:

I. LEJOHET dhënia në shfrytëzim – pa kompensim e pronës komunale, të tokës bujqësore me sipërfaqe prej 5-6 hektarësh, që gjendet në rrugën lokale për në fshatin Nashec, e evidentuar si pronë shoqërore e KK Prizren, për ndërtimin e kompleksit shkollor nga ana e qendrës edukative-arsimore „Gulistan“.

II. AUTORIZOHET Kryetarin e Komunës së Prizrenit që përmes organeve komunale (Drejtorisë së Administratës - Sektori për çështje pronësore-juridike dhe Avokaturës Publike-Komunale) që në procedurë të veçantë, pas bisedimeve me Institucionin që specifikohen në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, që në pajtim me ligjet në fuqi, sa i përket kohëgjatjes, mënyrës së shfrytëzimit dhe kushtet e tjera, të marrë aktvendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit pa kompenzim të pjesës së pronës së paluajtshme nga KK Prizren në dobi të qendrës edukative-arsimore „Gulistan“ për periudhën kohore që lejohet me ligjet në fuqi të cilat rregullojnë këtë çështje, me qëllim të ndërtimit të kompleksit të ri shkollor me infrasrukturën përcjellëse.

10. Për zbatimin e këtij vendimi të Kuvendit të Komunës së Prizrenit 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, për dhënien e pronës komunale për shfrytëzim të përhershëm, kryetari i komunës, sipas detyrës zyrtare (ex officio) në procedurën e marrjes së tokës ndërtimore nga ana e shfrytëzuesit të tanishëm, në përputhje me nenin 17 dhe 25 të Ligjit për tokën ndërtimore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës“ nr. 44/80), njësia 128.2 (d) dhe neni 82 i Ligjit për Procedurën Administrative nxori **AKTVENDIMIN** Nr.01-370 të 24 nëntorit 2010, me të cilin:

I. MERRET toka e regjistruar në emër të Organizatës Punuese të pyjeve „Sharri“-**OPB** Ekonomia e Pyjeve, dhe bartet në pronësi të Komunës së Prizrenit, ku sipërfaqja e asaj pjese të pronës së paluajtshme **50300 m²** e regjistruar si ngastër kadastrale në vendin e quajtur „Boka-Boka“ me një sipërfaqe të përgjithshme prej **474434 m²**, sipërfaqe e regjistruar në certifikatën për të drejtat e paluajtshme **nr. 553**, ZK Korishx“.

11. Më 9 shkurt 2011, në Prizren është lidhur marrëveshje për kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme mes kryetarit të komunës së Prizrenit z. Ramadan Muja dhe shfrytëzuesit QEA „Gulistan“ ku në nenin 1 të kontratës vërtetohet si në vijim:

“Ngastra kadastrale me nr. 800/2 prej 50300m² e ZK Korishë, pronë e KK Prizren, i jepet në shfrytëzim QEA „Gulistan“, në përputhje me vendimin e KK Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009 në periudhë kohore prej 40 vjetësh, duke u bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës nr.03/L-226 të 28.10.201, ndërsa Komuna e Prizrenit ruan të drejtën e pronësisë, deri në ndonjë ndryshim eventual në ligjet dhe në aktet tjera juridike të Republikës së Kosovës, që rregullojnë këtë lëmi“.

12. Përveq kontratës së lartpërmendur, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor – KK Prizren si (qiradhënës) i N.T.P. „Kamila“-SH.P.K. –(nr. Fiskal - 600108741)-si (qiramarrës) për 10 vjet (10+ 10) me mundësi vazhdimi“ , në Prizren më 15 prill 2011, kanë lidhur kontratën nr. 04-353 për shfrytëzimin e tokës komunale dhe përcaktimin e qirasë për ndërtimin e objektit – të fabrikës së çokolladës.
13. Parashtruesi i kërkesës çështjen e ligjshmërisë të këtyrë vendimeve, aktvendimeve dhe kontratave të lartpërmendura është përpjekur ta vejë në rendin e ditës të seancës së XIII të KK-së së Prizrenit e cila është mbajtur më 16 qershor 2011, mirëpo këtë kryesuesi i Kuvendit nuk ia ka lejuar sepse rendi i ditës për seancën e XIII-të të KK Prizren ishte caktuar paraprakisht.
14. Më 1 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar një ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal duke paraqitur Ministrinë si organ përgjegjës për mbikëqyrje administrative të punës së pushtetit lokal, për parregullsitë me rastin e nxjerrjes së vendimeve, aktvendimeve dhe kontratave të lartpërmendura.

15. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në përgjigjen ndaj ankesës nr. 463-576 të 13 korrikut 2011 në bazë të nenit 81.4 të Ligjit për Pushtetin Lokal nr. 03/L-040, Ligji për dhënjën në shfrytëzim dhe zëvendësim të pronës së paluajtshme të Komunës nr. 03/L-040, dhe pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesë dhe të dëshmive të paraqitura, është konstatuar si në vijim:

“Dhënja e pronës së komunës në shfrytëzim D.T.P. „Kamila d.o.o.“ dhe kompanisë QEA „Gulistan“ është në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të cilët përcaktojnë se, Kuvendi i Komunës ka të drejtë për të dhënë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës në periudhë prej dhjetë (10) vjetësh, në pajtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin për prokurim publik, dhe në periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vjetë, por jo më shumë se katërdhjetë (40) vjetë pas përmbushjes së kriterit të përcaktuar me Ligj për prokurim dhe pas dhënjes së aprovimit nga ana e Ministrisë së Financave dhe aprovimit paraprak nga ana e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë“.

“Në bazë të asaj që është përmendur më lartë dhe me qëllim të zbatimit të Ligjit për Pushtet Lokal, Ministria për Administratë të Pushtetit Lokal kërkon nga organet komunale, përkatësisht nga Kryetari i Kuvendit të komunës së Prizrenit, të ndërmarrë hapa konkretë në mënyrë që dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës nga ana e Kuvendit të Komunës, të bëhet më respektimin e dispozitave të Ligjit nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.“

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kuvendi i Komunës në Prizren me marrjen e vendimeve, aktvendimeve dhe kontratave të lartëpërmendura ka shkelur nenin 3 (Barazia para Ligjit), 24 (Barazia para Ligjit), 46 (Mbrotjtja e Pronës), dhe 52 (Përgjegjësia për Mjedisin jetësor) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
17. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për:

“Vërtetimin e shkeljes së dispozitave ligjore me vendimet arbitrare të Kryetarit të KK Prizren, Ramadan Muja, si përgjegjës kryesor në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe Kryesuesit Nijazi Kryeziu dhe PRISHJEN e këtyre vendimeve joligjore dhe kontratave të lidhura në bazë të këtyre vendimeve, me të cilat do të arrihej qëllimi kryesor, që veprimi i Kuvendit të Komunës në Prizren të bazohet në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës“.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës thekson se nenet 3 (Barazia para Ligjit), 24 (Barazia para Ligjit), 46 (Mbrotjtja e Pronës) dhe 52 (Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë bazë për kërkesën e tij.
19. Kushtet e pranueshmërisë janë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës.
20. Nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës në kornizën juridike të kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës nga individët, parashohin

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.“

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

21. Në këtë rast konkret, parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së „ vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, me të cilin lejohet „...dhënia e pronës së komunës në shfrytëzim-pa kompenzim , të tokës bujqësore me sipërfaqe prej 5-6 hektarësh, e cila gjindet në rrugën lokale për në fshatin Nashec, e regjistruar si pronë shoqërore e KK Prizren, për ndërtimin e kompleksit shkollor nga ana e qendrës edukative-arsimore „Gulistan“. Gjithashtu edhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së kontratës që është lidhur si rrjedhojë e këtij vendimi, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese; „ANULIMIN e këtij vendimi joligjor dhe kontrates së lidhur në bazë të këtij vendimi“.
22. Kërkesa e tillë për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës në Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009 dhe të kontratës së lidhur në bazë të këtij vendimi për të mbrojtur interesat e të gjithë qytetarëve të Komunës së Prizrenit tregon se parashtruesi e konteston në abstrakt vendimin e cekur dhe kontratat. Nëse ky është qëllimi i parashtruesi të kërkesës, si individ, ai nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar.
23. Në fakt, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës si baze juridike për parashtrimin e kërkesës së tij. Përveq kësaj, parashtruesi nuk ka paraqitur argumente me të cilat do të dëshmonte se ai është viktimë e drejtëpërdrejtë nga miratimi i këtij vendimi dhe të kontratave të lidhura në bazë të këtij vendimi.
24. Vetëm individët, ashtu siç parashikohet në mënyrë eksplicite në nenin 113.2 deri 113.6 të Kushtetutës, janë palë e autorizuar që t'i drejtohen Gjykatës për çështjet e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë.
25. Përveq kësaj, sistemi kushtetues-juridik i Kosovës nuk parasheh „actio popularis“, i cili është modalitet i ankesave individuale që mundëson çdo individ, i cili përpiket të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me rastin e shkeljeve të tilla edhe pse nuk ka statusin e viktimës.
26. Sipas kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar që të kontestojë kushtetutshmërinë e vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe kontratës së lidhur në bazë të këtij vendimi në abstrakt dhe prandaj kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1a) dhe (3c) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani